

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ju nuk na përfaqësoni!
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/ju-nuk-na-per-faqesoni-i585847
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 16:04:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 16:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	aa3885f6ff6128c52b74c254f24d9728b93ad53794208359b41113e05ff3dced
TEKSTI	c22ab9bf304c58486f2fac841fa9079988295db4cb46f2b50090418df7b5bc37
PAMJA	470ef6900490c1aa76d9f1f779047bc625d2f8f4e25fdcda7219865793455b6b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b4641de55a5c0a1a915b6b6b69e22e1584ded8242deacf3677b902e27f0d3eb1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b8dae6c54853da1d85da2cfc2b078041a9e4d965e832e711de05f684850346bc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b4641de55a5c0a1a915b6b6b69e22e1584ded8242deacf3677b902e27f0d3eb1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

1e Ju nuk na përfaqësoni!"Fisi pret kthimin e kryetarit" - Demaliaj ironizon prritjen e Berishes ne Rinas: Shkoi te dentisti amerikan per te nderruar protezat para vdekjesRetefundit

Ju nuk na përfaqësoni!



13 Shtator 2026, 18:00Blog Nga Lajla Përnaska

Përfaqësimi dhe roli i grave deputete, është rikthyer në qender të debatit publik, nxitur dhe nga një skandal lidhur me shkeljen e kodit të veshjes nga deputete, duke mëpërkëmbur kështu institucionin më të lartë përfaqësues të shtetit, që është Kuvendi i Shqipërisë. Për më tepër, fokusimi tek "look-u" dhe jo tek puna e tyre si ligjvënëse, ka ulur standardin dhe besueshmërinë e vetë institucionit në sytë e publikut, e sidomos tek brezi i ri. Roli i ligjvënësit lidhet me cilësinë e ligjbërjes, transparencën dhe llogaridhënien ndaj publikut dhe jo me "estetikën personale".

Në kulturat politike evropiane ekziston një "kod i heshtur" i veshjes formale për deputetët e të dyja gjinive.

Në ndryshimet e kodit zgjedhor në 2008 (PD + PS), u fut "lista e mbyllur" për zgjedhjen e deputetëve, si dhe kuota gjinore 30% për gratë. Edhe pse është provuar se është një sistem që zhdukua përfaqësimin qytetar dhe ka delegjitimuar deputetët e listës së mbyllur (që i vendos kryetari i partisë dhe nuk i zgjedh qytetari), ky sistem vazhdon të mbahet në dakordësi (PS + PD)!

Por protesta qytetare 105-ditore dhe në masë opinionin publik, e refuzon këtë sistem përjashtues, që përcillet edhe në thirrjen e fuqishme të protestuesve: "Ju nuk na përfaqësoni!"

Nëse i referohemi realitetit në këto 5 raunde të zbatimit të saj, " lista e mbyllur" i jep kryetarit të partisë kontroll absolut mbi zgjedhjen e deputetëve, të cilët mund të rizgjidhen mandat pas mandati, pa pasur nevojë të përfaqësojnë qytetarët, apo të shpalosin vlera personale e performancë legislative.

Edhe me kuotën gjinore, gratë listohen sipas përzgjedhjes dhe preferencës së Kryetarit të Partisë, jo si rezultat i kontributit publik e politik, apo meritës së mbështetjes nga qytetarët.

Sigurisht që kjo ka prodhuar një formë false legjitimimi, pasi numri i grave në Kuvend rritet statistikisht, por pushteti real i vendimarrjes brenda parlamentit dhe brenda partisë mbetet tek kryetari i partisë. Pra, në vend që të hapë rrugë për gra e vajza në karrierë, me kontribute publike dhe kapital elektoral, kuota është bërë mjet shpërblymjeje personal, sipas preferencës dhe interesit të kryetarit të partisë (e rrethit të ngushtë të tij). Ka tashmë gra të zgjedhura si në PS, ashtu edhe në PD, jo vetëm me 1,2, por me 3, 4 deri 5 mandate, të dhuruara nga Kryetari i partisë me listë të mbyllur. Ky model jo përfaqësues, sigurisht ka krijuar një hendek mes deputeteve "të emëruara e të privileguara" dhe realitetit të grave e vajzave shqiptare, që përballen me plot vështirësi ekonomike, papunësi, mungesë mundësish e migrim të detyruar, si dhe ngarkesa të kujdesit familjar në përditshmërinë e tyre. Për më tepër, gratë përfituese të mandateve, nuk kanë ngritur kauza/ probleme të vetë kontigjentit të grave shqiptare, por thjesht i shërbejnë interesave të pushtetit të Kryetarit të partisë e sigurisht dhe interesit vetjak !!!

Kjo ka zhbërë edhe qëllimin origjinal të kuotës (përfaqësim e roli real i grave, jo thjesht prezencë numerike dhe interesa kryetarësh).

Por tashmë është e qartë se Kuota e ka mbaruar misionin e saj në Shqipëri.Beteja jonë 10 vjeçare si Lëvizje e gruas(1998-2008) deri sa futëm kuotën 30% për përfaqësimin e grave në Kuvend, i ka dhënë numerikisht rezultatet pozitive të saj (nga 7,2 % në 2008, sot ka 35,7% gra). Por koha provoi se vendimarrja personale e përzgjedhies nga Kryetarët e Partive,ka ulur mjaft standartin, duke thelluar një deficit të fortë përfaqësimi midis të emëruarave deputete të Kryetarëve dhe masës së madhe të grave e vajzave shqiptare, që ndihen të papërfaqësuara.

Si gratë ashtu edhe burrat që pretendojnë të jenë pjesë e Kuvendit të Shqipërisë, duhet të garojnë në garë të hapur, me rregulla loje të barabarta e me programe efikase zhvillimore (jo si megafonë të Kryetarit, me tallava, gallatë, trukime, sfilata, apo me dajre), duke u përballur me votuesit për të fituar (nëse munden), mbështetjen e tyre!

Ne jemi një shoqëri, që duhet të bëjmë çmos të ruajmë vlerat më të mira të bartura në breza.

Prandaj, deri në ndryshimin e këtij sistemi të kalbur politik, që ka prodhuar plot marioneta politike kryetarësh dhe që janë joperfaqesuese për masën e madhe të grave dhe vajzave shqiptare, do vazhdojë e fuqishme thirrja:

"JU NUK NA PËRFAQËSONI!"

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Kur pushteti politik abdikon ndaj atij gjyqësor](#)

16:13 Blog / 7 komente

Shënime nga Konventa e Teksasit në ShBA

12:00 Blog / 41 komente

[EuReporter artikull për kryebashkiakun, Veliaj deklaron: "Ende nuk e kam humbur shpresën"](#)

10:30 Blog / 9 komente

Demokracia jonë pa hardware dhe software?!

08:23 Blog / 10 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.